

REKOMANDIME NGA SEMINARI KOMBETAR

»PROMOVIMI I VARIETETEVE TE REJA TE MOLLES», MBESHTETUR NGA SNV/PROMALI DHE ORGANIZUAR NGA ADAD – SHOQATA E ZHVILLIMIT TE RRETHEVE MALORE

Tirane, me 22.11.2012

Trendi i zhvillimit te sektorit te molles me Shqiperi sugjeron se shpejti qe prodhimi vendas i molles do te tejkaloje kerkesen per molle vendi. Sipas vleresimeve te eksperteve, bazuar ne numrin e rrenjeve qe pritet te hyjne ne prodhim ne 2015, prodhimi i vendit pritet te jete 10 mije tone me i larte se kerkesa per molle.

Promali me asistencen profesionale te ADAD (Shoqata e Zhvillimit te Rretheve Malore) ka sjelle per here te pare ne tregun shqiptar te 35 varietete te reja te molles. Keto varietete karakteriozohen nga cilesite e meposhtme

- kane rezistence ndaj semundjeve, kryesisht kromes
- japin mundesi per zhvillimin e sektorit te prodhimit organik
- jane te pershtatshme per gatim dhe paticeri
- japin fruta te shijshem dhe cilesore
- japin fruta qe mund te ruhen me gjate ne mjedise ftohese
- kane hershmeri dhe voneshmeri – zgjatje e sezonit te frutave te fresket
- bejne te mundur zgjerim te zones se kultivimit

1. Nevoja per kultivimin e varieteteve te reja

Sic u permend me siper, pas pak vitesh, prodhimi i vendit do te tejkaloje kerkesen aktuale per molle vendi te varieteteve dhe cilesive ekzistuese. Kultivimi i varieteteve te reja te molles, do te beje te mundur:

- zevendesimin e importeve¹
- diversifikimin e konsumit
- zhvillimin e industrise se perpunimit te frutave
- eksportin e molleve

Mundesite e krijuara nga varietetet e reja te molles, sugjerojne nevojen per permiresimin e struktures varietore te molles, ne favor te varieteteve te reja

2. Strategjia e propozuar per permiresimin e struktures varietore te molles

Aspkete te kerkeses

1. *Varietetet e reja, fillimisht duhen testuar. Perzgjedhja e varieteteve per t'u testuar², ka nevoje te paraprihet nga nje studim tregu*

Sipas nje perspektive te zevendesimit te importeve, studimi i tregut do te duhet te mbaje parasysh kerkesat e tregut te brendshem (preferencat e konsumatorit per fruta te fresket, koha e konsumit, mundesite e perpunimit shtepiak e industrial, etj.). Sipas nje perspektive te nxitjes se eksporteve, studimi i tregut do te duhet te mbaje parasysh kerkesat e tregut te jashtem (varietetet e kerkuara, koha me e pershtatshme, aspekte te ruajtjes dhe marketingut, etj.).

¹ Edhe ne kushtet kur prodhimi do te kaloje konsumin, vendi do te vazhdoje te importoje molle te cilesive dhe varieteteve te caktuara, megjithese te sasive nen renie

² Ne tesim, mund te perfshihen me shume varietete, ndersa per kultivim duhet te rekomandohen me pak varietete

2. *Perzgjedhja e varieteteve per perdorim vendi, ka nevoje te shoqerohet me nje perpjekje afat-mesme te edukimit te konsumatorit*

Aktivite indikative te kesaj fushate te edukimit te konsumatorit jane : (i) fushata promionale te shitjes se frutave nga molle te varieteteve te reja me cmime te ulta, (ii) udhezime mbi te ushquerit te shendetshem, te pergatitura nga MBUMK dhe Ministria e Shendetise dhe Ministria e Arsimit, (iii) pjesemarrja ne festivale te molles me pavijone te varieteteve te reja (iv) emisione televizive mbi menytrat e gatimit te molles, (v) shperndarje falas te sasi promionale te varieteteve te reja per nxenesit e shkollave, dhe institucionet e tjera sociale.

Aspekte te ofertes

1. *Te negociohet paraprakisht me mbajtesit e se drejtes pronesise intelektuale te varieteteve per te bere te mundur «marrjen ne perdorim» e se drejtes se pronesise intelektuale, nga ADAD/FERT te mbeshteur nga Promali, meqenese i kane sjelle ne Shqiperi ne vitet 2011/2012.*

Ketu eshte fjala per negociata me krijuesit e varieteteve te reja ne France. Disa nga varietetet e reja te sjella ne tregun shqiptar jane varietete « klubi », dmth varietete te mbrojtura qe nuk mund te perdoren lirisht. Mbajtesve e se drejtes pronesise intelektuale mund tu kerkohet qe Shqiperia te perdore disa nga keto varietete, me argumentin se kapaciteti i ofertes shqiptare eshte i tille qe nuk krijon shtremberime ne tregun evropian e boteror.

2. *Te demonstrohen disa nga cilesite e varieteteve te reja ne fidanishten e Zemblakut*

Demonstrimi pritet te behet ne shkalle shume te ngushte, per te « ekspozuar » disa nga tipat e varieteteve te reja. Nje nderhyrje e tille do te kerkonte nje mbeshtetje te fidanishtes Zemblak ne forme projektesh te vogla, ose te financuara nga qeveria, ose nga donatorët ; ne rastin e dyte qe mund te ishte edhe me i mundeshmi, qeveria mund te orientoje projekte donatoresh ne kete ngritjen e parcelave te vogla « ekspozimi »

3. *Te testohet nje numer varietetesh per cilesi te vecanta*

Testimi mund te behet per tipare te vecanta (rezistence, hershmeri, vonshmeri, pershtatshmeri per gatim, qendrushmeri, etj), ne zona te ndryshme te vendit. Ai mund te behet ne fermere pilot, bazuar ne nje partneritet publik privat. Aktore qe mund te marrin pjese ne kete partneritet jane Fidanishtja Zemblak, Fermere private qe jane dakord te marrin pjese ne testim, QTTB-ja Korce, ADAD (e te tjere kompani konsulente ne fushen e pemetarise), Universiteti Bujqesor i Tiranes dhe ai i Korces, etj. Numri i varieteteve qe duhen testuar mund te jete i gjere, por numri i varieteteve qe duhen rekomanduar per kultivim duhet te jete me i ngushte per te bere te mundur krijimin e nje mase kritike oferte.

4. *Te kalohet ne kultivimin ne nivel komercial te varieteteve te reja. Qeveria mund te konsideroje subvencionimin e mbjelljes se fidanave nga varietete te reja te molles*

Subvencioni mund te mbaje parasysh sa me poshte : (i) rajonizimin – varietete te caktuara i shkojne zonave te caktuara (ii) garancine qe kemi te bejme me fidana nga varietete te reja – per kete mund te konsiderohet rimbursimimi findanave permes fidanishtjes Zemblak.

Pergatiti :

Engjell Skreli Promali
Hafuz Domi ADAD